



Pranuar / Dorezuar Punijene / Prodato Received / Delivery	16 - 12 2021	viti god year	
Organ / Njesia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	6198/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.905/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.905/2021, të parashtruar nga ankuesi të datës 04.11.2021, me adresë banimi: Rruga "Dervish Rozhaja", Nr.54, Bregu i Diellit, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Policisë së Kosovës në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.905/2021 e datës 04.11.2021 e parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 31.05.2018 i punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit në pozitën "Zyrtar i Lart i Teknologjisë Informativë", i pakënaqur me institucionin punëdhënës për shkak të mos realizimit të shtesave në pagë sipas vendimit nr.07/29 të datës 31.07.2008 dhe vendimit nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 07.10.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Institucionit të Avokatit të Popullit me datë 25.10.2021 ka nxjerr vendimin me numër:222/2021 duke bërë përfundim procedimi lidhur me ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër vendimit të datës 25.10.2021 me numër:222/2021 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, me datë 04.11.2021 ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli: 5284/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.11.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Institucionit të Avokatit të Popullit. Institucioni më datë 15.11.2021 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë 1/15.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër protokollit 5284/2021 e datës 04.11.2021 me shkresat e bashkangjitura 1/17; Akt emërimit të ankuesit të datës 31.05.2018; Vendimin e Komisionit të Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit i datës 25.10.2021 me numër protokollit:222/2021; Ankesën e ankuesit të datës 07.10.2021 të parashtruar në Komisionin e Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit; E-mailin e datës 04.10.2021 dërguar nga _____ për ankuesin; Kërkesën e ankuesit për shtesa në pagë të datës 16.09.2021; Vendimin e datës 31.07.2008 më numër:07/29; Vendimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës të datës 08.10.2008 më numër: Nr.02/39 së bashku me listën aneksin I; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.11.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 15.11.2021 me numër protokollit: 5440/2021; E-mailin e datës 04.10.2021 dërguar nga _____ për ankuesin; Vendimin e Institucionit të Avokatit të Popullit i datës 06.02.2017; Lista tabelore e pozitave të vendeve të punës, gradave dhe koeficientet e pagave në IAP; Kopjen e konkursit të datës 20.02.2018 për pozitën Zyrtar i IT-së në IAP; E-mailin e datës 19.11.2021 i protokolluar me numër 5548/2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit _____ cila pretendon për njohje të plotë të shtesës në pagë të fushës së Teknologjisë Informativë sipas vendimit nr.07/29 të datës 31.07.2008 dhe Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe pagesës në mënyrë retroaktive nga data 31.05.2018 të shtesave në pagë bazuar në vendimin në fjalë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi duke iu referuar Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me datë 16.09.2021 ka parashtruar kërkesë për pagesën e shtesave mbi pagën bazë tek Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm me datë 04.10.2021 i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke e udhëzuar të njëjtin që t'i drejtohet komisionit të Ankesave lidhur me kërkesën në fjalë, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Institucionit të Avokatit të Popullit me datë 25.10.2021 ka nxjerr vendimin me numër:222/2021 duke bërë përfundim procedimi lidhur me ankesën e ankuesit, me këshillën juridike që pala mund të parashtojë ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes se kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës se njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si



dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, se paku një herë në muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkritazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, tani më është i pa bazuar, sepse ankuesi pretendimet e tij i bazon në një akt juridik i cili tani më nuk ka fuqi juridike, prandaj si rrethanë faktike dhe ligjore për refuzimin e ankesës së ankuesit ka marr për bazë faktin se pretendimet e ankuesit janë bazuar në një akt juridik që nuk ka afekt ligjor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatoje se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofroje Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analize që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar. listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Si dhe shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.905/2021

Flakron GASHI



Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Avokatit të Popullit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Institucionin e Avokatit Popullit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

